



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuer më: 25.02 20 20		
Priljeno:		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
12-320	11485	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 4 dhe 9 të Rregullores për kushtet, kriterët dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1NR.110-623 të datës 26.09.2008 dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënjën e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë 1Nr.400 –6211 i datës 31.01.2020, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari bën këtë:

SHPALLJE

I. Qëllimi i shpalljes për aplikim

Qëllimi i shpalljes për aplikim është përkrahja e fermerëve për vitin 2020, fermerët do të përkrahen me serra në sipërfaqe prej 50 m², dhe motokultivator.

II. Kriteret për aplikim për serra

- Të jenë banorë të Komunës së Lipjanit
- Toka me qenë në territorin e Komunës së Lipjanit
- Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës së paku 100m²
- Përparësi kanë fermerët të cilët dëshmojnë që kanë vijuar trajnime relevante/specifike në lëminë e perimkulturës.
- Përparësi kanë aplikuesit që kanë burime të mjaftueshme të ujitjes.
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë përfutuar në dy vitet e fundit nga Komuna apo ndonjë donatorë tjetër, dhe bujqësinë e kanë prioritet primar

III. Kriteret për aplikim për motokultivator

- Të jenë banorë të Komunës së Lipjanit
- Toka me qenë në territorin e Komunës së Lipjanit
- Përparësi kanë aplikuesit të cilët kanë serra në sipërfaqe prej 1 ari e me shume , nëse nuk arrihet numri atëher vijnë në konsiderim edhe aplikuesit të cilët kanë serra nën 1 ari dhe aplikuesit të cilët kanë pemishte dhe perime në fushë të hapur
- Përparësi kanë fermerët që nuk kanë përfituar në dy vitet e fundit nga Komuna apo ndonjë donator tjetër.

IV. Dokumentet e bashkangjitura

Aplikuesit duhet të dorëzojnë aplikacionin së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Kopja e letërnjoftimit
- Fletëposedim për patundshmëri, (të jetë në emër të aplikuesit ose të ndonjë antari të familjes dhe të jetë origjinal)
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (të jetë origjinal)

V. Koha dhe mënyra e pranimi të aplikacioneve

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit,
- Aplikacioni për plotësim mund të shkarkohet nga web-faqja e Komunës ose mund të merret në zyret e Drejtoratit të Bujqësisë dhe së bashku me dokumentat e bashkangjitura duhet të dorëzohet në zyret pritëse të Arhives së Komunës

VI. Përzgjedhja

- Aplikimet kontrollohen, pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren nga komisioni,
- Komuna e Lipjanit do të lidhë Marrëveshje me përfituesin e serrës, dhe të motokultivatorit i cili obligohet që të mos e bëjë tjetërsimin (shitje, dhënie në shfrytëzim etj.)
- Komisioni është i obliguar që të mbaj procesverbal për çdo aplikues.

Sqarim:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

Vërejtje:

- Aplikimi mund të bëhet vetëm për njëërën masë (për serrë në sipërfaqe prej 50 m² ose për motokultivator).

Lipjan:
25.02.2020

